



VENDIM

Nr. 84, Datë 09.06.2016

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “BIOPOWER GREEN ENERGY”
SH.P.K, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TE LICENSES NR. 64 SERIA
NPM08P, TE DHENE ME VENDIMIN E BORDIT TE
KOMISIONEREVE NR. 90, DATE 06.08.2008, NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015, Për Sektorin e Energjisë të Elektriqe; Nenit 5 dhe 6, të Rregullores për Procedurat e Heqjes së një Liçense”; neneve 16 pika 2 dhe 18 te Rregullave te praktikës dhe procedurave te ERE miratuar me vendimin nr 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar; gërmat, “a”, “d”, “e” të Vendimit nr. 90, date 06.08.2008 të Bordit të ERE-s, pikës 1.2; 1.6 dhe 1.7 të kushteve te liçensës Nr .64, Seria NPM08P datë 06.08.2008, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 09.06.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit te Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE ne licencen e shoqërisë BIOPOWER GREEN ENERGY sh.p.k,

Konstatoi se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë, ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k per shtyrjen e afateve për realizimin e projektit duke përfshire këtu edhe kolaudimin e veprës.
- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet :
 - Vendimin e Bordit te Komisionereve Nr. 20, date 08.03.2010,
 - Vendimin e Bordit te Komisionerëve Nr. 93, date 06.09.2011,
 - Vendimin e Bordit te Komisionerëve Nr. 137, date 15.11.2013.
- Me shkresën me Nr. 4/15 Prot, date 03.04.2015, shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k, ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen me 12 muaj të

afateve te licensës se ndërtimit te dhënë me Vendimin e Bordit te Komisionerëve te ERE-s me Nr. 90, date 06.08.2008, i ndryshuar së fundmi me vendimin Nr. 137, date 15.11.2013.

- Mospërmbushja e pikës 1 gërma “e” te vendimit 90 datë 06.08.2008, i ndryshuar e bën licencën te pavlefshme.
- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit nr.43/2015 "Per sektorin e energjise elektrike" , ERE me iniciativën e vetë mund të heqë licencën.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1.Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “BIOPOWER GREEN ENERG” sh.p.k, për zgjatjen e afatit të licenses Nr .64, Seria NPM08P datë 06.08.2008, per Ndërtim, Instalim, Shfrytëzimin të Centrale Elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike te Parkut Eolik “BPGE 1” dhe “BPGE 2”, Shëngjin, Lezhe te dhënë me Vendimin e Bordit te Komisionerëve te ERE-s me Nr. 90, date 06.08.2008.

2. Fillimin e procedurave për heqjen e licensës së shoqërisë “BIOPOWER GREEN ENERGY” sh.p.k, Nr .64, Seria NPM08P, dhënë me Vendimin e Bordit te Komisionerëve te ERE-s me Nr. 90, date 06.08.2008.

3.Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI